



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit: 22.05.1-2017-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË**  
**KLINËS**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

**Prishtinë, qershor 2018**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të (Komunës së Klinës), në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Arian Haxha Udhëheqës Ekipi, Fanol Hodolli dhe Elvir Krasniqi Anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Luljeta Morina.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	22
5 Qeverisja e mirë.....	23
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	26
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	28
Shtojca III: Letër konfirmimi .....	35

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Klinës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 27/11/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Klinës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes.

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, përveç mbivleresimit të të hyrave për 146,109€ si pasojë e prezantimit të të hyrave indirekte (gjobave të trafikut dhe gjykatave) të cilat mbledhen nga institucionet qendrore.


#### **Theksimi i çështjes**

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se:

- Një pjesë e pronës komunale, si dhe pagesat për projektet kapitale në vlerë 135,320€ nuk janë regjistruar në regjistrin e pasurisë në SIMFK. Në anën tjetër, në regjistrin e pasurisë janë përfshirë pasuri të cilat nuk janë më në pronësi të komunës.
- Regjistri i pasurisë nën 1,000€ (e-pasuria) nuk është përditsuar ende me të dhënat e nga Drejtoria e Shëndetsisë dhe Arsimit.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore****Përgjigja e menaxhmentit- 2017**

Menaxhmenti ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës së Klinës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e komunës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Klinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

#### Baza për opinionin të kualifikuar

Të hyrat e realizuara gjatë viti 2017 ishin mbivlerësuar për 146,109€ sepse ishin përfshirë gabimisht edhe të hyrat nga gjobat e trafikut dhe gjykatave<sup>1</sup>. Kjo ka rezultuar në një gabim material të prezantimit të të hyrave në Pasqyrat Vjetore Financiare dhe për këtë arsye ne kemi kualifikuar opinionin tonë.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek

---

<sup>1</sup> Te hyrat nga gjobat e trafikut si dhe te gjykatave, prezantohen si të hyra në PFV-të e institucioneve të nivelit qendror të cilat i mbledhin ato (Policia e Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si dhe Agjencia e Pyjeve të Kosovës).

---

pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZKA është i pavarur nga komuna dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

### **Theksimi i çështjes**

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Një pjesë e pronës komunale siç janë dy vetura, pesë lokale/ndërtesa afariste, dy banesa, 25 hektar tokë, si dhe pesë pagesa për projekte kapitale, në vlerë 135,320€ nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël të SIMFK-së. Në anën tjetër gjashtë traktorë dhe katër rimorkio për traktor të cilat nuk i ka më në pronësi komuna i ka përfshirë në regjistrin kontabël në SIMFK-së; dhe
- Regjistri i pasurisë nën 1,000€ (e-pasuria) nuk është përditsuar ende me të dhënat e nga Drejtoria e Shëndetsisë dhe Arsimit.

Kjo reflekton pasaktësi në regjistrat e pasurisë dhe shpalosje jo të saktë të tyre në PVF-të e vitit 2017. Opinioni ynë nuk është i kualifikuar në lidhje me këtë çështje.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV**

Kryetari i Komunës së Klinës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet



---

mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalsjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parave publike;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Plani fillestar dhe final i prokurimit;
- Raportet e rregullta tremujore për Kuvendin Komunal dhe diskutimi i raporteve të AB-së dhe ZKA-së nga KK; dhe
- Raportet e rregullta tremujore për thesarin, përfshirë Pasqyrat Nëntëmujore.

Konsiderojmë se komuna ka keq klasifikuar shpenzimet duke mbivlerësuar investimet kapitale në vlerë prej 21,840€ për shkak të pagesave të realizuar nga kjo kategori për pastrimin e borës që për nga natyra këto shpenzime i takojnë natyrës së mallrave dhe shërbimeve. Kjo ka ndikuar në prezantimin jo adekuat të shpenzimeve në kategoritë përkatëse.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, përveç çështjeve të cilat janë identifikuar te baza për opinionin dhe theksim të çështjes.

---

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

**Rekomandimi 1** Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Kualifikim dhe Theksim të Çështjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet te prezantimi i shënimeve në PVF. Me tutje, e gjitha pasuria, përfshirë pronat të cilat i posedojnë si dhe pasuritë jo financiare duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë, ndërsa pasuritë të cilat nuk janë më në pronësi të Komunës duhet të largohen nga regjistrat.

Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

#### Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash përfshirë të hyrat dhe shpenzimet kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë zbatimi i plotë i procedurave të prokurimit sidomos te fusha e investime kapitale ku në disa raste komuna ka dështuar t'i respektoj në plotësi kërkesat ligjore gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit. Gjithashtu komuna duhet konsideroj shtimin e kontrollit në kategorinë e të hyrave, llogarive të arkëtueshme, dhe pagesën me kohë të obligimeve. Sfidë e komunës mbetet edhe menaxhimi dhe raportimi i pasurisë.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>8,645,555</b>	<b>9,270,769</b>	<b>8,742,972</b>	<b>8,271,869</b>	<b>8,611,908</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	7,615,034	7,814,738	7,726,650	7,511,739	7,616,657
Të bartura nga viti paraprak <sup>3</sup> -	-	328,662	305,515	196,119	351,515
Të hyrat vetjake <sup>4</sup>	1,030,521	1,030,521	614,981	522,829	599,139
Donacionet e brendshme	-	17,022	16,000	31,362	40,447
Donacionet e jashtme	-	79,826	79,826	9,820	4,150

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga MF.

<sup>3</sup> Të hyrat vetjake të komunës të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>4</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 625,214€ apo 7%. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore dhe të jashtme prej 96,848€, vendimit të qeverisë për rritjen e grantit 199,704€ si dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak prej 328,662€.

Në vitin 2017, OB ka shpenzuar 94% të buxhetit final ose 8,742,972€, niveli i ekzekutimit të buxhetit ishte i njëjtë edhe në vitin 2016 ( 94%).

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>8,645,555</b>	<b>9,270,769</b>	<b>8,742,972</b>	<b>8,271,869</b>	<b>8,611,908</b>
Pagat dhe Mëditjet	5,656,411	5,675,310	5,669,197	5,674,868	5,570,740
Mallrat dhe Shërbimet	660,364	671,720	618,254	606,417	620,164
Shërbimet komunale	151,258	221,405	200,330	161,095	170,353
Subvencionet dhe Transferet	65,767	78,235	76,899	61,656	79,502
Investimet Kapitale	2,111,755	2,624,099	2,178,292	1,767,833	2,171,149

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Rritja e buxhetit final për paga dhe mëditje ( për 18,899€) në krahasim me buxhetin fillestar është rezultat i rritjes nga të hyrat e bartura prej 6,700€, donacioneve në vlerë 11,597€ si dhe vendimit të qeverisë në vlerë 602€. Realizimi i buxhetit në këtë kategori është 99.9%;
- Rritja e buxhetit final për mallra dhe shërbime është rezultat i rritjes nga të hyrat e bartura prej 11,356€. Realizimi i buxhetit për mallra dhe shërbime është 92%;
- Rritja e buxhetit final për shpenzime komunale (për 70,147€) në krahasim me buxhetin fillestar është rezultat i rritjes nga të hyrat e bartura prej 147€ si dhe vendimit të qeverisë në vlerë 70,000€. Realizimi i buxhetit për shpenzime komunale është 90.5%;
- Po ashtu buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar është rezultat i rritjes nga të hyrat e bartura prej 12,468€. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 98%;
- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar është rritur për 512,344€. Rritja është si rezultat i të hyrave të bartura prej 297,991€, donacioneve në vlerë 85,251€ si dhe vendimit të qeverisë në vlerë 129,102€. Realizimi i buxhetit në këtë kategori është 83%.

## Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Klinës në 2017 janë në vlerë 663,268€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë e bizneseve, të hyrat nga qiraja etj.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 <sup>5</sup> Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,030,521	1,030,521	663,268	698,936	643,615
<b>Totali</b>	<b>1,030,521</b>	<b>1,030,521</b>	<b>663,268</b>	<b>698,936</b>	<b>643,615</b>

Tatimi në pronë i faturuar gjatë vitit 2017 ishte 332,509€, prej tyre janë arkëtuar 135,086€ apo 41%. Përpos të hyrave të prezantuara në tabelë, Komuna e Klinës kishte edhe të hyra indirekte nga dënimet në trafik dhe gjobat në vlerë 146,109€.

Vlen të theksohet se komuna ka arrite gjate këtij viti të verifikojë 3,728 prona, krahas 11,604 pronave të evidentuara në bazën e të dhënave për tatimin në pronë.

### Çështja 2 -Mos aplikimi i cilësisë së objekteve në vlerësimin dhe tatimin në pronë

**E gjetura** Zyra Komunale e Tatimit në Pronë nuk ka marrë parasysh cilësinë e objekteve me rastin e kalkulimit të ngarkesës tatimore. Në bazë të UA nr.03/2011 mbi mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesit duhet të klasifikohet gjendja e objekteve sipas faktorit të cilësisë së ndërtimit e shprehur në koeficient, e cila varësisht prej gjendjes së objektit (shumë e dobët, e dobët, mesatare, e mirë dhe e shkëlqyeshme) rritë apo e zvogëlon ngarkesën tatimore). Sipas zyrtarëve të tatimit në pronë mos aplikimi i cilësisë së objekteve në vitin 2017 ishte pasojë e mungesës së stafit.

**Rreziku** Mos klasifikimi i gjendjes së objekteve mund të ndikojë që ngarkesa tatimore të mos jetë në përputhje me gjendjen reale të pronës ku si rezultat tatimpaguesit mbingarkohen/nën ngarkohen me tatime në raport kërkesat e legjislacionit. Kjo gjithashtu mund të ketë ndikim në të hyrat e realizuara nga tatimi në pronë.

**Rekomandimi 2** Kryetari i komunës duhet të siguroar se janë ndërmarr veprimet e nevojshme për kalkulimin e drejtë të ngarkesave tatimore ndaj taksapaguesve duke aplikuar kriterin e cilësisë së objekteve në përputhjeje me koeficientet e përcaktuar nga ligjvënësi.

<sup>5</sup> Pranimet për vitin 2016/2015 përfshijnë edhe të hyrat indirekte.

### 3.3 Pagat dhe shtesat

Komuna ka arrit ta shfrytëzoj 100% të buxhetit final për paga dhe shtesa të cilat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe MF. Kontrollat kyçe që aplikon komuna janë monitorimi dhe nënshkrimi i listave të pagave nga zyrtaret kompetent.

#### Çështja 3 – Mos respektimi i kriterëve të konkursit publik

**E gjetura** Në dy rastet në vijim kemi vërejtur se komuna kishte punësuar staf pa shpallur konkurs publik. Në SHFMU “At Gjergj Fishta” në Jagodë është angazhuar një mësimdhënës i mësimit klasor dhe në Sh.M “Tre dëshmorët” në Jashanicë është angazhuar një zyrtar/ndihmës, duke mos aplikuar procedurat e punësimit. Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës, punëdhënësi është i obliguar që të shpall konkurs publik.

Me tutje, në SHFMU “At Shtjefën Gjeqovi” në Zllakuqan për pozitën Drejtor shkollë ishte shpallë konkursi publik me date 13/06/2017 i cili është anuluar nga komisioni me datë 17/07/2017 për shkak të mungesës së konkurrencës. I njëjti konkurs ishte rishpallur me datë 20/07/2017 dhe pas përfundimit të procedurës nga paneli intervistues, ishte anuluar prapë për shkak të rezultateve jo të kënaqshme të kandidateve. Megjithatë për këtë pozitë, me vendimin e Kryetarit si ushtrës detyre ishte emëruar njëri nga kandidatët e konkursit të anuluar (për shkak të rezultateve të dobëta të treguara nga aplikuesit). Për më tepër i emëruari si ushtrues detyre për këtë pozitë nuk kishte qenë pjesë përbërëse e stafit të kësaj shkollë.

**Rreziku** Punësimi i stafit pa konkurs paraqet mos respektim të parimit të konkurrencës, transparencës dhe trajtimit të barabartë si dhe njëherësh rrit rrezikun që stafi i punësuar të mos jetë kompetent për pozitën e caktuar. Për më tepër, kjo mund ta dëmtojë edhe cilësinë e arsimit në shkolla.

**Rekomandimi 3** Kryetari duhet t’i rishikojë arsyet e mos ndjekjes së procedurave të punësimit siç parashihen me legjislacionin përkatës dhe të vendosë kontrole të duhura për të siguruar që punësimi i zyrtareve bëhet vetëm përmes konkursit publik.

### 3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra, shërbime dhe shpenzime komunale në vitin 2017 ishte 671,720€. Prej tyre ishin shpenzuar 618,254€ apo 92% të buxhetit final. Shpenzimet kryesisht kanë të bëjnë me pagesat për komunal, udhëtime, telekomunikim, shërbime, blerje e mobileve dhe pajisjeve, derivate dhe lëndë djegëse, shërbime të regjistrimit dhe sigurimit, mirëmbajtje e të tjera.

Komuna kishte planifikuar 108 aktivitete të prokurimit, mirëpo kishte realizuar vetëm 66 aktivitete për shkak të mos inicimit të aktivitete nga njësitë kërkuese. Konsiderojmë se komuna cakton menaxher të kontratave të cilët konfirmojnë punët e kryer/mallrat/shërbimet e pranuar para pagesës.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 78,235€. Prej tyre në 2017 janë shpenzuar 76,899€ apo 92% të buxhetit final. Shpenzimet kryesisht kanë të bëjnë me mbështetje të aktiviteteve kulturore, sportive apo ndihma momentale.

#### Çështja 4 – Mungesa e dëshmime kthyesë për arsyetimin e subvencionit.

- |                      |  |
|----------------------|--|
| <b>E gjetura</b>     | Në një rast përfituesi i subvencioneve në vlerë totale 9,000€, nuk kishte përgatitur raporte financiare dhe nuk kishin ofruar dëshmi, të cilat do të dëshmonin se subvencioni është shfrytëzuar për qëllimin e dhënë. Vendimi të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit nr. 451-2774/2017 për ekzekutimin e vendimit të Kuvendit Komunës pika IV përcakton që përfituesi i subvencionit duhet t'i paraqes komunës një raport kthyes zyrtar të shpenzimeve. |
| <b>Rreziku</b>       | Mos raportimi i përfituesve të subvencioneve lidhur me realizimin e projekteve të subvencionuara rrit rrezikun që mjetet të shfrytëzohen për qëllime tjera dhe të mos arrihen objektivat e përcaktuara dhe si rrjedhojë ndikon në dëmtimin e buxhetit.   |
| <b>Rekomandimi 4</b> | Kryetari duhet të sigurojë se përfituesit e subvencioneve raportojnë për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve, dhe në rastet kur mjetet nuk shfrytëzohen për qëllimin e dhënë të ndërmerren masa ligjore ndaj përfituesve të subvencioneve.   |



### 3.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 2,624,099€. Prej tyre në 2017 komuna ka shpenzuar 2,178,292€. Ato kanë të bëjnë me rregullimin e infrastrukturës, ndërtim të objekteve, asfaltim të rrugëve, kanalizim pajisje, përmirësime të ndryshme të kapitalit e të tjera.

Komuna kishte planifikuar 56 aktivitete të prokurimit, mirëpo kishte realizuar 44 aktivitete, ose 12 më pak në raport me planifikimin. Disa nga aktivitetet e planifikuara nuk kanë mundur të realizohen për shkak të mungesës së mjeteve. Menaxhmenti kishte vendos kontrollë të mjaftueshme duke konfirmuar punën e kryer para çdo pagese, po ashtu për secilën kontratë kishte caktuar menaxher të kontratës.

#### Çështja 5 - Vlerësimi i ofertave në kundërshtim me LPP-në

**E gjetura** Tek aktiviteti i prokurimit për “asfaltimin e rrugëve: lloti 1 - në fshatin Jashanicë lagja Myrtaj dhe loti 2 - në fshatin Shtupel – lagja Bakaja”, komuna kishte eliminuar operatorin ekonomik i cili kishte ofertuar me çmimin më të ulët për të dyja llotet ( vlera e ofertës: Lloti 1 - 61,106€, dhe Lot 2 - 54,643€), me arsyetimin se bazuar në njoftimin për kontratë OE mund të ofertoj vetëm në njërin llot, derisa OE kishte ofertuar në të dyja llotet. Në këtë rast janë shpërblyer me kontratë ofertuesit me çmime më të larta, të cilët kishin ofertuar vetëm në njërin llot ( kontratat me vlerë për Lot 1- 66,981€ dhe Lot 2- 60,131€).

Eliminimi i OE vetëm pse kishte ofertuar në të dyja llotet është në kundërshtim me LPP-së neni 27/A dhe rregulloren e prokurimit, neni 19 ku specifikohet se autoriteti kontraktues mund të ndajë aktivitetin e prokurimit në lloje homogjene apo heterogjene dhe të kufizojë numrin e llojeve që do të mund të shpërblehen tek një tenderues, por operatorët ekonomik janë të lirë të zgjedhin për sa se cilat pjesë do të ofertojnë. Kjo kishte ndodhur sepse kishte mospërputhje ndërmjet rregullores së prokurimit neni 19.2 dhe LPP-së neni 27, ku KRPP më pastaj kishte nxjerrë vendim për ndryshimin e këtij neni tek rregullorja e PP-së.

**Rreziku** Eliminimi i operatorit ekonomik i cili kishte ofruar çmimet më të lira me arsyetimin se kishte ofertuar në të dyja llotet është në kundërshtim me LPP-në dhe ndikon në dëmtim të buxhetit.

**Rekomandimi 5** Kryetari duhet të sigurojë se vlerësimi i tenderëve do të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe se në rast të mospërputhjeve ndërmjet dispozitave të LPP-së dhe dispozitave të Rregullores së PP-së dominojnë dispozitat e LPP-së. Megjithatë në raste të tilla mund të kërkohet interpretim ligjor nga KRPP-ja.



---

**Çështja 6- Mangësi në vlerësim të ofertave**

- E gjetura** Te aktiviteti i prokurimit për ndërtimin e kanalizimit në Jashanicë Loti 1 - Lagja Shpati dhe Bajraktari, komuna kishte eliminuar operatorin ekonomik i cili kishte ofertën më të lirë (vlera e ofertës 48,448€) me arsyetimin se pika 4 dhe 5 (caktimi i validitetit të tenderit) te formulari për dorëzimin e tenderit nuk kanë qenë të plotësuarra narrativisht nga OE, megjithëse sigurimi i tenderit ishte dorëzuar si dokument valid. Bazuar në LPP-në neni 59.2 dhe neni 59.4, autoriteti kontraktues/komuna mund të kërkojë sqarime me shkrim nga OE, dhe se mund të konsideroj një tender të përgjegjshëm edhe nëse përmban gabime apo paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material, pa shkaktuar ndryshim material në kriteret dhe kërkesat tjera në dosjen e tenderit. Mirëpo komuna nuk kishte kërkuar sqarime shtesë për këtë rast dhe kishte shpërblyer me kontratë një ofertues tjetër me çmim prej 82,191€, duke tejkalluar kështu edhe buxhetin e planifikuar për këtë projekt.
- Rreziku** Eliminimi i ofertuesve me çmime të favorshme për gabime teknike dhe shpërblyeri me kontratë të ofertuesve me çmim dukshëm më të lartë, dëmton buxhetin dhe rrit rrezikun e përballjes me drejtësinë për shkak të mosrespektimit të rregullave dhe trajtimit jo korrekt të konkurruesve.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të sigurojë se janë vendos kontrolle funksionale që garantojnë një vlerësimi korrekt të ofertave në përputhje me kërkesat ligjore me qëllim të maksimizimit të vlerës për paranë e shpenzuar.

**Çështja 7 - Regjistrimi i shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate**

- E gjetura** Shpenzimet për investime kapitale në vlerë 282,581€ janë regjistruar gabimisht në kodin ekonomik 31910 si avanse për investime kapitale, ndonëse ishin shpenzuar për ndërtim të rrugëve, objekteve dhe rregullim të lumenjve.
- Rreziku** Regjistrimi i shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate rezulton me paraqitje dhe shpallje jo të drejtë të shpenzimeve bazuar në natyrën reale të shpenzimit brenda një kategorie të caktuar.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të sigurojë se regjistrimi i shpenzimeve bëhet në kode adekuate siç parashihet me planin kontabël të SIMFK-së me qëllim të prezantimit dhe shpalljes së informatave të drejta për shfrytëzuesin e raporteve financiare.

---

### 3.7 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

---

#### Çështja 8 - Pagesat me vendime gjyqësore

- E gjetura** Sipas vendimeve gjyqësore gjatë vitit 2017, nga Thesari janë ekzekutuar pagesa prej 14,816€. Me këtë rast komuna ka paguar 3,000€ si shpenzime shtesë për procedurë gjyqësore, përmbartimore dhe interes. Shkaku i këtyre pagesave ishin kryesisht vonesat në shlyerjen e obligimeve.
- Rreziku** Realizimi i pagesave të bazuara në vendimeve gjyqësore ndikojnë në dëmtimin e buxhetit për shkak të paraqitjes së shpenzimeve përmbartimore, interesit, taksat, etj.
- Rekomandimi 8** Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë e detajuar për shkaqet e ekzekutimit të pagesave me vendime gjyqësore dhe të ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e tyre me qëllim eliminim e pagesave shtesë për vendime gjyqësore.

**Çështja 9 - Mos respektimi i parimeve për ndarjen e detyrave**

**E gjetura** Për të gjitha kontratat e nënshkruara gjatë vitit 2017, me vendimin e udhëheqësit të prokurimit janë caktuar menaxheret e projekteve, dhe i njëjti zyrtar ishte caktuar në shumicën e rasteve. Ndërsa në dy raste planet për menaxhimin e kontratës nuk ishin përgatitur. Bazuar në LPP-së dhe rregullës së udhëzuesit operativ, Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) është përgjegjës për caktimin e menaxherit të projektit për secilën kontratë, gjithashtu autoriteti kontraktues duhet të hartoj një plan të menaxhimit të kontratës.

Më tutje, bazuar në rregulloren Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë, ZKA vendos dhe formon komisionin për pranimin e pasurisë jo financiare. Ndërsa komisionet për mbikëqyrje dhe pranim teknik ishin formuar me vendimin e menaxherëve të projekteve.

**Rreziku** Mosrespektimi i parimeve për ndarjen e detyrave përveç që është në kundërshtim me legjislacionin përkatës rrit rrezikun për paraqitjen e konfliktit të interesit dhe /apo reduktim të objektivitetit gjatë përmbushjes së detyrave të përcaktuara. Mungesa e planeve për menaxhimin e kontratave mund të rezultojë me cilësi të ulët të punëve/mallrave/shërbimeve si dhe vlerë të ulët për paranë e shpenzuar.

**Rekomandimi 9** Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projektit për secilën kontratë, komisionet për mbikëqyrje dhe pranim teknik, formohen me vendimin e zyrtarit kompetent bazuar në legjislacionin në fuqi. Po ashtu planet për menaxhimin e kontratave duhet të përgatiten nga zyrtaret përgjegjës.

**Çështja 10 - Parashikim i dobët i sasive indikative të kontratës publike kornizë**

**E gjetura** Te aktiviteti i prokurimit (kontratë publike kornizë) për servisimin dhe mirëmbajtjen e fotokopjeve, printerëve, skanerëve dhe aparateve tjera të printimit, në dosjen e këtij tenderit komuna nuk kishte parashikuar drejtë sasinë indikative të furnizimeve/servisimeve, ashtu siç parashihet me nenin 9, 17 dhe 38 Ligjit të Prokurimit Publik.

**Rreziku** Mungesa e një vlerësimit formal të nevojave/kërkesave në aspektin sasior dhe me kohë rezulton me prokurim jo ekonomik dhe jo efikas. Gjithashtu edhe vlerësimet buxhetor mund të jenë të pasakta dhe komuna mund të përballet me probleme në ekzekutimin financiar të kontratës në të ardhmen.

**Rekomandimi 10** Kryetari duhet të sigurojë se njësitë kërkuese kryejnë vlerësimet e përafërta për qëllime furnizimi/blerjeje para inicimit të aktiviteteve të prokurimit për lidhjen e kontratave publike kornizë siç parashihet me LPP-në.

---

## 3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas regjistrit kontabël të SIMFK-së, vlera neto e pasurive kapitale (mbi 1,000€) është 81,399,964€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (nën 1,000€) është prezantuar 22,000€. Megjithatë ne vërejtëm mangësitë në vijim:

---

### Çështja 11 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë

**E gjetura** Rregullorja për menaxhimin e pasurive kërkon që raporti i inventarizimit të kryhet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që komisioni i inventarizimit të ketë mundësinë e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare. Komuna në fund të vitit ka themeluar komisionin për inventarizim, mirëpo i njëjti nuk kishte arritur ta përfundoj këtë proces para përgatitjes dhe dorëzimit të PFV-ve.

Gjithashtu, komuna nuk ka hartuar një rregullore apo procedurë të brendshme e cila do të përcaktonte qartë përgjegjësitë e secilit zyrtar për pasurinë e ngarkuar, në rast të tjetërsimit apo dëmtimit të pasurisë bazuar në nenin 4 të rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive.

**Rreziku** Angazhimi jo i duhur për azhurnimin e regjistrit të pasurisë reflekton mungesë të informatave të sakta dhe të plota lidhur me pasurinë në posedim. Kjo rritë rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet, apo tjetërsohet dhe njëherësh ndikon në prezantim jo të drejtë të gjendjes së tyre në PFV.

**Rekomandimi 11** Kryetari duhet të sigurojë që komisioni ka përfunduar raportin e inventarizimit para përgatitjes së PFV-ve. Raporti duhet të përfshijë krahasimin e gjendjes fizike me atë në gjendjen e regjistrave. Nëse konstatohen diferenca ato duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël.

### 3.9 Të arkëtueshmet

Komuna e Klinës ka prezantuar llogari të arkëtueshme në vlerë totale 1,923,000€ që kanë të bëjnë me: tatimin në pronë 1,235,000€, ngarkesa për afarizëm të bizneseve 509,000€, qiraja komunale e banesave 79,000, qiraja për lokale 85,000, qiraja për shfrytëzimin e pronës 13,000 si dhe qiraja për treg të hapur 1,000.

#### Çështja 12 - Mangësi në trajtimin e llogarive të arkëtueshme

- E gjetura** Llogaritë e arkëtueshme të Komunes së Klinës krahasuar me vitin paraprak ishin rritur për 122,000€. Megjithatë, komuna nuk kishte ndonjë plan dhe nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim për arkëtimin e tyre.
- Rreziku** Mungesa e kontrollit dhe mos aplikimi i masave adekuate pamundëson arkëtimin e të hyrave dhe rrit rrezikun e vjetërimit të kërkesave.
- Rekomandimi 12** Kryetari duhet të shqyrtoj në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar se të hyrat e dakorduara janë realizuar.

### 3.10 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 është prezantuar në vlerë 192,000€. Krahasuar me vitin paraprak obligimet janë rritur për 2%, ku vlera e obligimeve në fund të vitit 2016 ishte 188,000€. Këto janë bartur për t'u paguar në vitin 2018.

#### Çështja 13 - Vonesa në pagesën e faturave

- E gjetura** Në shtatë raste faturat/obligimet ndaj furnitorëve në vlerë totale 38,896€, komuna i kishte paguar pas afatit kohorë ligjor prej 30 ditësh. Bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, neni 39, organizatat buxhetore obligohen brenda 30 ditësh çdo fature të vlefshme të pranuar, ta procesojnë për pagesë.
- Rreziku** Kontrollat jo të mira në menaxhimin e obligimeve rrisin rrezikun e hyrjes në obligime pa mbulesë buxhetore apo përballje me drejtësinë duke krijuar edhe shpenzime shtesë dhe vështirësi buxhetore për vitet pasuese.
- Rekomandimi 13** Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pagesat realizohen brenda 30 ditëve pas pranimit të faturës siç kërkohet me LMFFPP.

---

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 të Komunës së Klinës ka rezultuar me 17 rekomandime. Komuna e Klinës kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet. Megjithatë, nuk janë marrë veprime të mjaftueshme pasi që plani i veprimit nuk është zbatuar në tërësi dhe mangësitë e njëjta vazhdojnë të përsëriten në disa fusha.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, tetë rekomandime janë zbatuar plotësisht, tri ishin në proces të zbatimit, ndërsa gjashtë nuk janë zbatuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe 16 rekomandime, dhe në vitin 2017, pesë nga to ishin zbatuar, tetë rekomandime tjera ishin në zbatim e sipër dhe tri nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

---

### Çështja 14 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga vitet paraprake

**E gjetura** Megjithëse, komuna ka hartuar me kohë planin e veprimit, vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar sepse komuna nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. Menaxhmenti i komunës nuk aplikon masa përgjegjësie për moszbatimin e rekomandimeve.

**Rreziku** Mos zbatimi i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të ndikojë në dobësi në menaxhim dhe raportim të shpenzimeve.

**Rekomandimi 14** Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore apo tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

## 5 Qeverisja e mirë

### Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Komuna e Klinës gjatë vitit 2017 kishte bërë përmirësime në qeverisje, duke hartuar dhe aprovuar strategjinë e zhvillimit ekonomik lokal, planet urbanistike, planin operativ emergjent si dhe planin e integritetit. Megjithatë, komuna ende nuk kishte hartuar regjistër të rreziqeve dhe plan për menaxhimin e rreziqeve.

Gjithashtu, auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive si: raportimi i dobët menaxherial, monitorim jo adekuat në zbatimin e plotë të rekomandimeve të ZKA-së, niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve të NJAB-it si dhe mos funksionimi i Komitetit të Auditimit.

---

## 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Në Komunën e Klinës është e themeluar Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) e cila operon me dy auditor. NJAB kishte hartuar planin strategjik dhe planin vjetor të punës për vitin 2017, ku kishte planifikuar gjashtë auditime, të cilat ishin realizuar në tersi sipas planit.

---

### Çështja 15 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të NjAB dhe funksionimi i kufizuar i Komitetit të Auditimit

**E gjetura** Auditimi ynë ka identifikuar disa dobësi në sistemin e auditimit të brendshëm si në vijim:

- Edhe pse NjAB për 2017 kishte realizuar gjashtë auditime dhe kishte dhënë rekomandime të vlefshme për përmirësim, menaxhmenti respektivisht njësitet e audituara nuk hartojnë plane për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe si pasojë kishte ngecje në zbatimin e tyre. Prej 29 rekomandimeve të dhëna në vitin 2017, vetëm tri rekomandime ishin zbatuar, pesë ishin në proces të zbatimit ndërsa 21 rekomandime nuk ishin adresuar fare; dhe
- Komiteti i Auditimit kishte mbajtur katër takime gjatë vitit 2017, ku prej tyre tri takime ishin mbajtura në fund vit, dhe si i tillë ishte pothuajse jo funksional dhe nuk i kishte shtuar vlerë auditimit të brendshëm dhe/apo menaxhimit të përgjithshëm në komunë.

**Rreziku** Mos përgatitja e planeve të veprimit dhe mosfunksionimi i Komitetit të Auditimit redukton aftësinë e mbikëqyrjes së aktiviteteve të NjAB-së dhe fuqizimin e mëtejshëm të rolit të auditimit të brendshëm. Si rrjedhojë, kjo mund të ndikojë në mos adresimin e dobësive në sistemin e kontrolleve të brendshme.

**Rekomandimi 15** Kryetari i Komunës duhet të analizojë shkaqet e mosfunksionimit të Komitetit të Auditimit dhe të ndërmerre veprime për të siguruar një funksionim efektiv dhe të plotë të Komitetit të Auditimit, si dhe të përgatisë dhe të zbatojë planin për zbatimin e rekomandimeve të NjAB-it për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e NjAB-së.



---

## 5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

---

### Çështja 16 - Dobësi në kontrollet menaxheriale

**E gjetura**                      Formati aktual i raportimeve menaxheriale nuk ofron bazë për kontrolle të brendshme efektive meqenëse raportimi me shkrim tek menaxhmenti i lartë bëhet vetëm sipas kërkesës dhe jo në baza të rregullta kohore. Si pasojë e kontrolleve jo të mira janë vërejtur dobësi në fushën e të hyrave, prokurimit, subvencioneve, rekrutim të stafit, si dhe menaxhimin e pasurisë.

Komuna e Klinës gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve. Nuk ekziston ndonjë regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së, ku do të bëhej identifikimi i rreziqeve të pritshme kundrejt objektivave, përcaktimi i mënyrës së menaxhimit të tyre dhe njësitë përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme.

**Rreziku**                         Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

**Rekomandimi 16**            Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose

---

---

individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

#### Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

---

## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.5 Rekomandimet për PFV	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime, në mënyrë që të njëjtat të mos përsëriten në vitet vijuese.	Po		
2.3 Pagesat sipas vendimeve gjyqësore.	Kryetari duhet të siguroj se janë bërë përpjekjet e nevojshme që punonjësit të paguhen sipas pozitave të planifikuara dhe vendimeve përkatëse të lëshuara. Më tej, të siguroj se komuna trajton të gjitha obligimet ligjore ndaj pretendentëve legjitim, në mënyrë që të mos të rezultojë deri të ekzekutimi i pagesave nga Thesari.		Janë bërë përpjekje për trajtimin e obligimeve ligjore ndaj pretendentëve legjitim, por mbetet sfide rregullimi i koeficienteve të punonjësve në administratën komunale.	
2.4 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit, zbatohet, rishikohet dhe i njëjti përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga AP, me stafin përgjegjës të emëruar, për një monitorim rigoroz të këtij procesi. Sugjerojmë që edhe përfaqësues nga Kuvendi Komunal të jenë pjesë e këtij procesi.			Nuk janë marrë masa.

2.5. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe në mënyrë proaktive të bëhet adresimi i fushave me dobësi të identifikuar. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës për përgjigjet e konfirmuara. Një kontribut të mirë në konfirmimin e pohimeve të vetëvlerësimit mund ta jap Njësia e Auditimit të Brendshëm.		Nuk janë ndërmarrë veprime për adresimin e fushave me dobësi të identifikuar në pyetëtorin e vetëvlerësimit.	
2.6.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për regjistrin e menaxhimit të rrezikut tek një drejtor përkatës (apo ngjashëm) i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhoj këtë proces dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi rreziqet.			Nuk janë marrë masa.
2.7 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë se sistemi i auditimit të brendshëm bëhet tërësisht funksional dhe përfitimet maksimale merren nga shërbimet e brendshme të sigurisë të ofruara nga AB. Nevoja për themelimin të Komitetit të Auditimit duhet të shqyrtohet.		Komiteti i auditimit ishte themeluar por nuk kishte dhënë ndonjë kontribut gjatë vitit 2017. Po ashtu rekomandimet e AB nuk janë zbatuar nga menaxhmenti.	
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të sigurojë se njësitë kërkuese vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim. Zyra e prokurimit duhet të shtoj kujdes në përcaktimin e pozicioneve, dhe gabimet e tilla të mos përsëriten. Harmonizimet e kontratave për reflektim të ndryshimeve fiskale duhet të bëhen në mënyrë të rregullt si dhe pagesa e paguar më tepër ndaj OE duhet t'i kthehet buxhetit komunal. Të kërkohet përgjegjësi për pagesat e pozicioneve jashtë kontratës bazë. Gjithashtu, komisionet të përpilojnë raport për furnizimet e pranuar, para dërgesës së lëndës për certifikim.		Është shënuar progres, mirëpo ende mbetet sfiduese që njësitë kërkuese të vlerësojnë drejtë kërkesat për prokurim.	

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të sigurojë se ndërmerren masa në mbikëqyrjen e marrëveshjeve me bashkëfinancim përfshirë kërkesat të qarta të raportimit gjatë implementimit dhe monitorimit të projektit, në pajtim me kërkesat e marrëveshjeve si dhe rregullave për shpenzimin e parasë publike. Tek rasti me Caritas, duhet të kërkohet llogaridhënie e plotë, në mënyrë që paratë e pa arsyetuara t'i kthehen buxhetit.	Po		
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të siguroj se do të miratohet një rregullore e brendshme e cila definon qartë kërkesat dhe përgjegjësitë për përdorimin e veturave. Personat përgjegjës për mbikëqyrjen e autoparkut duhet të sigurojnë se gjatë përdorimit të automjeteve zyrtare azhurnohen fletudhëtimet dhe veturat përdoren vetëm sipas aprovimeve të personave përkatës.		Është shënuar progres, mirëpo ende nuk është hartuar ndonjë rregullore e brendshme për përdorim të veturave.	
3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Kryetari të siguroj se zyrtarët e pagesave i zbatojnë kërkesat e rregulloreve dhe verifikojnë fondin e orëve për kompensim të kujdestarive, sipas kërkesës për veprim lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë.	Po		
3.5.3 Subvencionet dhe transferet	Meqenëse organizimi i festivalit mbahet rregullisht çdo vit, ne rekomandojmë që Kryetari i Komunës këtë aktivitet ta inkorporoj në buxhetin vjetor në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ndërsa organizimi i tij të bëhet përmes drejtorisë kompetente siç është paraparë me vendimin themelues. Të gjitha pagesat për financimin e festivalit duhet të kryhen përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit dhe atë pas konfirmimit të rregullsisë së shpenzimeve nga ana e zyrtarit çertifikues si dhe në kodin adekuat, mallra dhe shërbime. Përveç kësaj, procedurat e prokurimit duhet të zhvillohen në pajtim me ligjin dhe rregullat financiare.	Po		

3.6 Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që drejtoritë e angazhuara në mbledhjen e të hyrave monitorojnë procesin e buxhetimit dhe performancën e aktiviteteve inkasuese. Qiradhëniet të mbështeten me bazë të fortë ligjore.		Është shënuar progres, mirëpo ende mbetet sfidues niveli i ulët i inkasimit i të hyrave.	
3.6 Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se barazimet ndërdepartamentale duhet të kryhen në baza të rregullta mujore, derisa mjetet e mbledhura në arkë duhet të deponohen brenda ditës, në llogarinë komunale.		Barazimet ishin kryer por mbetet që mjetet e mbledhura në arkë të depozitohen brenda ditës në llogarinë e komunës.	
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se procesi gjithëpërfshirës i regjistrimit të pasurive do të vazhdoj dhe brenda një afati optimal do të nxirret një regjistër përfundimtar mbi pasuritë e komunës. Zyrtari për menaxhim të pasurisë dhe zyrtarët e angazhuar në pranimin e mallrave/pasurive të komunikojnë në mënyrë efektive për të shmangur mos zbatimin e kërkesave të rregullores.			Nuk janë marrë masa.
3.7.3 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të instaloj sistem të protokolimit të çdo fature të pranuar nga komuna dhe obligimet e sakta të raportohen në MF në baza mujore.	Po		
3.7.3 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të sigurojë se ZKF dhe Zyra ligjore bën një vlerësim të përafërt të detyrimeve kontigjente në mënyrë që shpaleshet në PVF të jenë përafërsisht të sakta. Për të shmangur kontestet gjyqësore, aktvititet, vendimet si dhe kontratat duhet të jenë legjitime dhe të menaxhohen në mënyrën e duhur. Kërkesat gjyqësore, të futen në projeksione buxhetore të kategorive përkatëse.		Është shënuar progres megjithatë ende mbetet sfiduese çështja e pagesave bazuar në vendime gjyqësore.	





Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2016	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për të siguruar regjistrim të saktë të pasurive. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.			Nuk janë marrë masa.
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të siguroj se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike, dhe aty ku ka nevojë, të propozohen masat adekuate.			Nuk janë marrë masa.
2.2 Pyetësori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Kryetari të siguroj se është rishikuar sistemi i qeverisjes, në veçanti në fushën e menaxhimit të rreziqeve dhe aprovimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik, si dhe një proces i monitorimit sistematik të aktiviteteve në këto dy fusha, duhet të vendoset brenda një periudhe të arsyeshme.		Është aprovuar strategjia e zhvillimit ekonomik, ndërsa menaxhimi i rreziqeve ende mbetet fushë sfiduese.	
2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike	Kryetari të hartoj dhe propozoj për miratim në Asamblenë Komonale planet strategjike për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të komunës, duke vendosur objektiva të qarta strategjike dhe duke mbikëqyrur dhe matur realizimin e tyre.	Po		
2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë. Një zgjidhje e përshtatshme duhet të vendoset deri në fund të këtij viti.			Nuk janë marrë masa.



2.4 Sistemi i auditimit të Brendshëm	Kryetari duhet të siguroj se janë përgatitur planet e veprimit për zbatim të rekomandimeve të nxjerra nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit duhet t'i rishikojë në mënyrë kritike burimet, planet dhe rezultatet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe të kontribuojë në përmirësimin e përgjithshëm të menaxhimit të komunës.			Nuk janë marrë masa.
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të siguroj që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar.	Po		
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të sigurohet se gjatë planifikimit të buxhetit vjetor të ketë në konsiderim të gjitha burimet potenciale të buxhetit, duke marrë për bazë edhe trendin të hyrave vetjake në tri vitet e fundit.	po		
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet ta shqyrtoj rastin pse kanë ndodhur mbingarkesat e qytetarëve me këto tarifa si dhe të sigurohet që në mënyrë strikte është duke u aplikuar rregullorja nr. 01/2014 për ngarkesa dhe gjoba komunale. Në të kundërtën, rregullorja duhet të ndryshohet dhe plotësohet sipas tarifave të reja.	Po		
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari të siguroj që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, komisioni i vlerësimit merr në konsiderim të gjitha nevojat reale të njësive kërkuese, respektivisht sasitë e nevojshme për furnizim, dhe eliminon të gjitha mundësitë e manipulimit me çmime. Përveç kësaj, zyrtari i prokurimit duhet të kujdeset që të furnizohen të gjithë artikujt e kontraktuar sipas sasive të porositura nga njësitë kërkuese, dhe jo vetëm artikujt me çmime të volitshme për operatorin.		Sa i përket kërkesave nga njësia kërkuese duhet të ndërmerren veprime shtesë për planifikim bazuar në nevoja reale.	
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të sigurojë se asnjë pagesë për shërbimet e mësipërme nuk do të kryhet para se të sigurohen çmimet furnizuese nga OE, dhe më pas, të kalkulojnë tarifat e servisimit dhe të mirëmbajtjes.	Po		

3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari të siguroj se organi mbikëqyrës raporton vonesat në realizimin e projekteve dhe menaxheri i projektit nuk pranon raportin nga personat përgjegjës pa datë të pranimit. Në rastet kur vonesat ndodhin pa arsye, penalet zbatohen siç janë kontraktuar si dhe dispozitat e kontratës ekzekutohen në tërësi	Po		
3.1.5 Çështjet e përbashkëta	Kryetari të siguroj se nënshkrimi dhe ekzekutimi i urdhërpagesave bëhet vetëm nga personat e autorizuar, dhe zyrtarët kyç të proceseve siç janë zyrtari certifikues dhe ai shpenzues, në rast të mungesës së tyre, të kenë zyrtarët alternativë.	Po		
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari të siguroj që regjistrat e pasurive të jenë të plotë dhe të saktë, dhe për dobësitë e identifikuar gjatë inventarizimit të merren veprime konkrete për përmirësim në pajtim me kërkesat e rregullores për menaxhim të pasurisë.			Nuk janë marrë masa.
3.2.2 Te arkëtueshmet	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur kontrole të përmirësuara dhe më efektive, në mënyrë që evidentimi dhe pasqyrimi i saldove të llogarive të arkëtueshme të jetë i saktë.	Po		
3.2.2 Te arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj se çdo qiradhënie të ketë kontratë valide dhe realizimi i saj të mbikëqyret në vazhdimësi, si dhe të aplikohen masa ligjore në mënyrë që të maksimizohet niveli i inkasimit. Në të kundërtën, shfrytëzimi i pronave komunale duhet të ndërpritet.			Nuk janë marrë masa.
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të forcoj kontrollet dhe të sigurojë se faturat protokollohen dhe Departamenti i financave do t'i evidentoj, kontrolloj dhe paguaj brenda afateve të përcaktuara ligjore të gjitha faturat e komunës.		Faturat protokollohen, megjithatë në disa raste ka vonesa në pagesën e obligimeve.	

## Shtojca III: Letër konfirmimi

	<b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b> <b>REPUBLIC OF KOSOVO</b> <b>REPUBLIKA KOSOVO</b>	<b>KOMUNA E KLINËS</b> <b>MUNICIPALITY OF KLINA</b> <b>OPŠTINA KLINA</b>	
<a href="http://www.komuna-klina.org">www.komuna-klina.org</a>			

**LETËR E KONFIRMIMIT**

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

**Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Klinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA


**KOMUNA KLINË**  
**MUNICIPALITY OF KLINA**  
**OPŠTINA KLINA**

Nr.No.Br. 401-4906/18

Data-Date-Datum 25.06.2018

Klinë-Klina

z.Zenun Elezaj



Kryetar i Komunës,

Data: 25.06.2018, Klinë,

